



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 14, datë 19.02.2025

P Ë R

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "STRUKTURË HOTELERIE
DHE REZIDENCA TURISTIKE 1, 2, 3, 4 DHE 5 KATE MBI TOKË, ME TARRACË TË
SHFRYTËZUESHME, ME 1 KAT NËNTOKË, ME MUR RRETHUES DHE PISHINË",
ME VENDNDODHJE NË BASHKINË VLORE

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese shoqërive "Lux Project" sh.p.k dhe "4A-M" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

V E N D O S I:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Strukturë hotelerie dhe rezidenca turistike 1, 2, 3, 4 dhe 5 kate mbi tokë, me tarracë të shfrytëzueshme, me 1 kat nëntokë, me mur rrethues dhe pishinë", me vendndodhje në Bashkinë Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë "Lux Project" sh.p.k. dhe "4A-M" sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkuar vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Vlorë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

E D I R A M A



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

BLENDI GONXHJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 24/12 2025